



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 290, Datë 23.12.2024**

**MBI**

**KËRKESËN PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E  
ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “SA-GLE KOMPANI”  
SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pika dhe 5, dhe nenit 10, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1832/9 prot., datë 20.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin nr. 151 datë 10.06.2022 “Mbi kërkesën e shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj” dhe dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k.”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 123, date 29.08.2012, për një afat 30-vjecar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 633 prot., datë 05.05.2022, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 151, datë 10.06.2022, u vendos pezullimi i vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj, duke i

lënë detyrë shoqërisë që të dokumentojë në ERE vendimin përfundimtar të organeve përkatëse në lidhje me heqjen e sekuestros mbi kuotat dhe transferimin e 100% të kuotave të saj.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1832, datë 28.08.2024, nga Zyra e Përmbartimit Privat “TDR GROUP” sh.p.k. si dhe shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1832/4 prot., datë 17.10.2024 nga shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. u depozitua dokumentacion se nuk ka më asnjë procedim penal të regjistruar në ngarkim të shoqërisë. Sa më sipër rezulton se nuk ekziston më kushti pezullues i vendimit të bordit nr. 151/2022. Në të tilla rrethana vlerësohet të hiqet ky pezullim dhe të vijohet me shqyrtimin e dokumentacionit përkatës për kërkesën e shoqërisë për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar, ERE me shkresën nr. 1832/5 prot., datë 04.11.2024, i evidentoi shoqërisë informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit të saj.
- Në vijim, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1832/6 prot., datë 21.11.2024 dhe nr. 1832/8 prot., datë 16.12.2024, shoqëria ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e munguar.
- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria me korrespondencën vijuese të realizuar me ERE-n, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.
- Shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Heqjen e pezullimit të vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. të vendosur në vendimin e bordit të ERE-s nr. 151 datë 10.06.2022.
2. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k.

3. Ortaku i vetëm i shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. bëhet shoqëria “AG Hpower & Construction” sh.p.k.
4. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**